3. Dosje nr. 318 “Informacion për pajisjen e mëtejshme të Sektorit të kontrollit postar të Degës V me aparatura dhe aksesoret përkatës” me 4 (katër) fletë ndër të cilat 1 (një) dokument me 2 (dy) fletë është i klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Sekret”.
Dosja i përket Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.
4. Dosje nr. 317 “Informacion për materialet e kontrollit postar e telefonik” me 5 (pesë) fletë ndër të cilat 2 (dy) dokumente me 4 (katër) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”.
Dosja i përket Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.
5. Dosje nr. 137 “Informacion mbi disa probleme që dalin për sektorin e kontrollit postar e telefonik” me 5 (pesë) fletë ndër të cilat 1 (një) dokument me 3 (tre) fletë është i klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Sekret”.
Dosja i përket Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.
6. Dosje nr. 139 “Korrespondencë e përkohshme, shkresa e materiale operative” me 177 (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë) fletë ndër të cilat 177 fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”.
Dosja i përket Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.
7. Dosje nr. 328 “Informacione mbi organizimin e punës në seksionin e kontrollit postar e telefonik dhe disa mendime për shkurtime në strukturën organike të këtij seksioni” me 9

(nëntë) fletë ndër të cilat 3 (tre) dokumente me 7 (shtatë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”.

Dosja i përket Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

8. Dosje nr. 323 “Akte kontrolli mbi disa probleme të konstatuara nga ndihma e kontrollit të ushtruar në kontrollin postar të Degëve të Punëve të Brendshme Elbasan Shkodër, Fier, Korçë” me 25 (njëzet e pesë) fletë ndër të cilat 7 (shtatë) dokumente me 24 (njëzet e katër) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”.

Dosja i përket Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

9. Dosje nr. 151 “Konkluzione për punën e bërë nga kuadrot e kontrollit postar gjatë dy viteve, raporti vjetor i saj dhe statistikat mujore për zbulimin, parandalimin e veprimtarisë së mundshme armiqësore nëpërmjet kontrollit postar” me 38 (tridhjetë e tetë) fletë ndër të cilat 2 (dy) dokumente me 27 (njëzet e shtatë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”.

Dosja i përket Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

10. Dosje nr. 210 “Përgjithësim i Degës V për veprimtarinë armiqësore të zbulimeve të huaja nëpërmjet përfaqësive diplomatike duke shfrytëzuar kanalin postar e telefonik” me 23 (njëzet e tre) fletë ndër të cilat 1 (një) dokument me 22 (njëzet e dy) fletë është i klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Sekret”.

Dosja i përket Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

11. Dosje nr. 37 “Udhëzim i Ministrit të Punëve të Brendshme për kontrollin postar, telefonik e telegrafik” me 17 (shtatëmbëdhjetë) fletë ndër të cilat 1 (një) dokument me 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë është i klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Sekret”.

Dosja i përket Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

12. Dosje nr. 205 “Studim i Degës V për riorganizimin e punës në sektorin e kontrollit postar” me 4 (katër) fletë ndër të cilat 1 (një) dokument me 3 (tre) fletë është i klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Sekret”.

Dosja i përket Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

13. Dosje nr. 17 “Plan pune dhe informacioni i grupit të punës për thellimin e punës e sqarimin e procesit të postës kufitare” me 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë ndër të cilat 2 (dy) dokumente me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”.

Dosja i përket Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

14. Dosje nr. 107 “Informacion mbi gjendjen e laboratorit fiziko - kimik të kontrollit postar dhe masat që duhet të merren” me 17 (shtatëmbëdhjetë) fletë ndër të cilat 1 (një) dokument me 4 (katër) fletë është i klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Sekret”.

Dosja i përket Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

15. Dosje nr. 138 “Informacion dërguar Komitetit Qendror të Partisë mbi veprimtarinë armiqësore nëpërmjet kontrollit postar dhe atij telefonik” me 8 (tetë) fletë ndër të cilat 1 (një) dokument me 8 (tetë) fletë është i klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Sekret”.

Dosja i përket Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

16. Dosje nr. 22 “Udhëzim i Ministrit të Punëve të Brendshme për kontrollin postar, telefonik e telegrafik” me 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë ndër të cilat 1 (një) dokument me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë është i klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Sekret”.

Dosja i përket Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

17. Dosje nr. 89 “Material mbi kontrollin postar si një nga llojet e rëndësishme të punës agjenturiale operative” me 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë ndër të cilat 1 (një) dokument me 18 (tetëmbëdhjetë) fletë është i klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Sekret”.
Dosja i përket Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.
18. Dosje nr. 90 “Informacione dërguar udhëheqjes së partisë dhe shtetit mbi letrat e kapura nga kontrolli postar me përmbajtje jo të mirë” me 26 (njëzet e gjashtë) fletë ndër të cilat 10 (dhjetë) dokumente me 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”.
Dosja i përket Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.
19. Dosje nr. 111 “Letër udhëzuese dërguar degëve të punëve të brendshme mbi disa veprime të gabuara të sektorit të kontrollit postar” me 3 (tre) fletë ndër të cilat 1 (një) dokument me 2 (dy) fletë është i klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Sekret”.
Dosja i përket Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.
20. Dosje nr. 3 “Vendim i Këshillit të Ministrave mbi valutën dhe sendet e tjera që dërgohen nga të arratisurit dhe udhëzimi i Ministrit mbi kontrollin postar dërguar Degëve të Punëve të Brendshme” me 21 (njëzet e një) fletë ndër të cilat 4 (katër) dokumente me 19 (nëntëmbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”.
Dosja i përket Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.
21. Dosje nr. 120 “Raport llogaridhënie i kryetarit të degës së kontrollit postar para sektorit” me 7 (shtatë) fletë ndër të cilat 1 (një) dokument me 6 (gjashtë) fletë është i klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Sekret”.
Dosja i përket Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.
22. Dosje nr. 110 “Analizë mbi organizimin e punës agjenturiale operative në sektorin e kontrollit postar gjatë viteve 1976-1977 dhe detyrat për të ardhmen” me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë ndër të cilat 1 (një) dokument me 14 (katërmëdhjetë) fletë është i klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dokumentet në dosje datojnë në vitin 1977.
Dosja i përket Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.
23. Dosje nr. 125 “Raporte mbi punën e bërë për zbulimin e veprimtarisë armiqësore të zhvilluar nëpërmjet kontrollit postar si dhe bisedave telefonike” me 43 (dyzet e tre) fletë ndër të cilat 3 (tre) dokumente me 42 (dyzet e dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”.
Dosja i përket Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.
24. Dosje nr. 130 “Detyrat funksionale të shërbimit të kontrollit postar të jashtëm e të brendshëm” me 16 (pesëmbëdhjetë) fletë ndër të cilat 1 (një) dokument me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë është i klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Sekret”.
Dosja i përket Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.
25. Dosje nr. 145 “Informacione dërguar Komitetit Qendror të PPSH mbi disa probleme që ka nxjerrë kontrolli postar e doganor” me 28 (njëzet e tetë) fletë ndër të cilat 14 (katërmëdhjetë) dokumente me 20 (njëzet) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”.
Dosja i përket Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.
26. Dosje nr. 22 “Instruksion mbi administrimin dhe mbajtjen e postës sekrete në organet shtetërore” me 23 (njëzet e tre) fletë ndër të cilat 11 (njëmbëdhjetë) dokumente me 23 (njëzet e tre) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret”.

Dosja i përket Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

27. Dosje nr. 83 “Relacion mbi shpërndarjen e postës sekret e tepër sekret në rrethet e Republikës” me 3 (tre) fletë ndër të cilat 1 (një) dokument me 3 (tre) fletë është i klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret”.

Dosja i përket Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

28. Dosje nr. 93 “Instruksion mbi marrjen, ruajtjen dhe shpërndarjen e postës sekrete dhe tepër sekrete dhe udhëzimi i Ministrit mbi administrimin e dokumenteve” me 8 (tetë) fletë ndër të cilat 2 (dy) dokumente me 8 (tetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret”.

Dosja i përket Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

29. Dosje nr. 96 “Mbi shpërndarjen e postës sekrete dhe tepër sekrete në rrethe” me 4 (katër) fletë ndër të cilat 1 (një) dokument me 4 (katër) fletë është i klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret”.

Dosja i përket Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

30. Dosje nr. 97 “Relacion i Ministrisë së mbrojtjes dhe Degës së Shifrës mbi transferimin e postës” me 4 (katër) fletë ndër të cilat 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret”.

Dosja i përket Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit.

KRYETARI I KDZH

Dr. Gentiana Sula

Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendim nr. 15, datë 30.05.2022

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””, i ndryshuar, kreu III, neni 13, pika b), në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu II, neni 4, pika a), c), dhe në Udhëzimin nr. 99, datë 13.04.2018 “Për zbatimin e vendimit nr. 662, datë 15.11.2017 për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me Urdhër nr. 13, datë 03. 05. 2018 të Kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror””, i ndryshuar në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, **me vendimin nr. 15, datë 30.05.2022** si më poshtë:

Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH,

deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. Dosje Formulare nr. 531 në ngarkim të L. Y, me 25 (njëzet e pesë) fletë ndër të cilat 7 (shtatë) dokumente me 8 (tetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret” dhe 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Operativ.
2. Dosje Objekti Dega e Legalitetit në Sh.B.A me 89 (tetëdhjetë e nëntë) fletë ndër të cilat 4 (katër) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret” dhe 48 (dyzet e tetë) dokumente me 81 (tetëdhjetë e një) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e II.
3. Dosje Objekti Dega e Legalitetit në Kanada me 61 (gjashtëdhjetë e një) fletë ndër të cilat 6 (gjashtë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret” dhe 16 (gjashtëmbëdhjetë) dokumente me 45 (dyzet e pesë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e II.
4. Dosje Objekti Dega e Legalitetit në Francë me 202 fletë ndër të cilat 8 (tetë) dokumente me 11 (njëmbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret” dhe 125 (njëqind e njëzet e pesë) dokumente me 145 (njëqind e dyzet e pesë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e II.
5. Dosje Objekti Dega e Legalitetit në Turqi me 28 (njëzetë tetë) fletë ndër të cilat 4 (katër) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret” dhe 17 (shtatëmbëdhjetë) dokumente me 22 (njëzet e dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e II.
6. Dosje Objekti Dega e Legalitetit në Angli me 51 (pesëdhjetë e një) fletë ndër të cilat 5 (pesë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret” dhe 21 (njëzet e një) dokumente me 22 (njëzet e dy) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e II.
7. Dosje Objekti Dega e Legalitetit në Republikën Federale Gjermane me 105 (njëqind e pesë) fletë ndër të cilat 8 (tetë) dokumente me 12 (dymbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret” dhe 41 (dyzet e një) dokumente me 60 (gjashtëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e II.
8. Dosje Objekti Dega e Legalitetit në Australi me 78 (shtatëdhjetë e tetë) fletë ndër të cilat 7 (shtatë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret” dhe 17 (shtatëmbëdhjetë) dokumente me 41 (dyzet e një) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e II.
9. Dosje Objekti Dega e Legalitetit në Suedi me 328 (treqind e njëzet e tetë) fletë ndër të cilat 7 (shtatë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret” dhe 114 (njëqind e katërmëdhjetë) dokumente me 228 (dyqind e njëzet e tetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e II.
10. Dosje Objekti Dega e Legalitetit në Belgjikë me 328 (treqind e njëzet e tetë) fletë ndër të cilat 6 (gjashtë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret” dhe 146 (njëqind e dyzet e gjashtë) dokumente me 215 (dyqind e pesëmbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”. Dosja i përket Fondit Drejtoria e II.

11. Dosje Personale nr. 4010 “Kujunxhiu” në ngarkim të M. M., me 40 (dyzet) fletë ndër të cilat 11 (njëmbëdhjetë) dokumente me 12 (dymbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret”. Dosja i përket Fondit Operativ.

KRYETARI I KDZH

Dr. Gentiana Sula

Bibliografia e informacionit të deklasifikuar në AIDSSH me vendim nr. 16, datë 10.06.2022

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””, i ndryshuar, kreu III, neni 13, pika b), në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kreu II, neni 4, pika a), c), dhe në Udhëzimin nr. 99, datë 13.04.2018 “Për zbatimin e vendimit nr. 662, datë 15.11.2017 për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror”, në AIDSSH, i ngritur me Urdhër nr. 13, datë 03. 05. 2018 të Kryetarit të Autoritetit “Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror””, i ndryshuar në AIDSSH”, ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, **me vendimin nr. 16, datë 10.06.2022** si më poshtë:

Fondi arkivor i ish-Sigurimit të Shtetit që administrohet nga AIDSSH,

deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

20. Dosje Objekti Legaliteti me 303 (treqind e tre) fletë ndër të cilat 11 (njëmbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret” dhe 37 (tridhjetë e shtatë) dokumente me 118 (njëqind e tetëmbëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”.
Dosja i përket Fondit Drejtoria e II.
21. Dosje Objekti Legaliteti me 493 (katërqind e nëntëdhjetë e tre) fletë ndër të cilat 9 (nëntë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret” dhe 146 (njëqind e dyzet e gjashtë) dokumente me 221 (dyqind e njëzet e një) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”.
Dosja i përket Fondit Drejtoria e II.
22. Dosje Objekti Legaliteti me 280 fletë ndër të cilat 4 (katër) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret” dhe 125 (njëqind e njëzet e pesë) dokumente me 228 (dyqind e njëzet e tetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”.
Dosja i përket Fondit Drejtoria e II.
23. Dosje Objekti Legaliteti me 383 fletë ndër të cilat 6 (gjashtë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret” dhe 207 (dyqind e shtatë) dokumente me 290 (dyqind e nëntëdhjetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”.
Dosja i përket Fondit Drejtoria e II.

24. Fashikull studime krerësh të O.K.LL me 57 (pesëdhjetë e shtatë) fletë ndër të cilat 8 (tetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret”.
Dosja i përket Fondit Drejtoria e II.
25. Dosje O.K.LL Legaliteti në vitet 1964-1965 me 178 (njëqind e shtatëdhjetë e tetë) fletë ndër të cilat 127 (njëqind e njëzet e shtatë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret”.
Dosja i përket Fondit Drejtoria e II.
26. Dosje Fashikullore mbi aktivitetin e komunitetit qendror O.K.LL me 51 (pesëdhjetë e një) fletë ndër të cilat 4 (katër) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret”.
Dosja i përket Fondit Drejtoria e II.
27. Dosje “Përpyjekjet e Legalitetit për bashkim me grupet e tjera” me 58 (pesëdhjetë e tetë) fletë ndër të cilat 24 (njëzet e katër) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret” dhe 1 (një) fletë është e klasifikuar me nivelin e klasifikimit “Sekret”.
Dosja i përket Fondit Drejtoria e II.
28. Dosje Legaliteti në vitet 1962-1963 me 288 (dyqind e tetëdhjetë e tetë) fletë ndër të cilat 23 (njëzet e tre) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret”.
Dosja i përket Fondit Drejtoria e II.
29. Dosje me dokumente origjinale mbi aktivitetin e degës O.K.LL në Belgjikë me 136 (njëqind e tridhjetë e gjashtë) fletë ndër të cilat 9 (nëntë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret”.
Dosja i përket Fondit Drejtoria e II.
30. Fashikull mbi divergjencat e O.K.LL me 121 (njëqind e njëzet e një) fletë ndër të cilat 23 (njëzet e tre) dokumente me 35 (tridhjetë e pesë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret”.
Dosja i përket Fondit Drejtoria e II.
31. Dosje Organizata Kombëtare e Lëvizja e Legalitetit me 125 fletë ndër të cilat 21 (njëzet e një) dokumente me 26 (njëzet e gjashtë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret”.
Dosja i përket Fondit Drejtoria e II.
32. Dosje Fashikullore “Zalli” në ngarkim të Abaz Kupi me 69 (gjashtëdhjetë e nëntë) fletë ndër të cilat 20 (njëzet) dokumente me 27 (njëzet e shtatë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret”.
Dosja i përket Fondit të Veçantë.
33. Dosje Objekti Legaliteti me 626 (gjashtëqind e njëzet e gjashtë) fletë ndër të cilat 83 (tetëdhjetë e tre) dokumente me 106 (njëqind e gjashtë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret” dhe 161 (njëqind e gjashtëdhjetë e një) dokumente me 191 (njëqind e nëntëdhjetë e një) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”.
Dosja i përket Fondit Drejtoria e II.
34. Dosje Objekti Legaliteti me 260 (dyqind e gjashtëdhjetë) fletë ndër të cilat 9 (nëntë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret” dhe 134 (njëqind e

tridhjetë e katër) dokumente me 224 (dyqind e njëzet e katër) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Sekret”.

Dosja i përket Fondit Drejtoria e II.

35. Dosje Objekti Legaliteti me 187 (njëqind e tetëdhjetë e shtatë) fletë ndër të cilat 57 (pesëdhjetë e shtatë) dokumente me 98 (nëntëdhjetë e tetë) fletë janë të klasifikuara me nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret”.

Dosja i përket Fondit Drejtoria e II.

KRYETARI I KDZH

Dr. Gentiana Sula



AKTIVITETE

TË AUTORITETIT TË ZHVILLUARA GJATË PERIUDHËS
MAJ-QERSHOR 2022

AKTIVITETE TË AUTORITETIT TË ZHVILLUARA GJATË PERIUDHËS MAJ-QERSHOR 2022

Takim i Kryetares së Autoritetit me studentë të Institutit të Historisë në Universitetin e Tiranës

Më 6 maj, Kryetarja e Autoritetit Dr. Gentiana Sula, prezantoi pranë Departamentit të Historisë në Universitetin e Tiranës, me prani të Prof. Dr. Valentina Duka dhe studentëve të historisë, veprimtarinë e Autoritetit dhe botimet 📖 një pjesë e të cilave janë punuar në bashkëpunim me Institutin e Historisë.

"Narrativa e së shkuarës është e rëndësishme të ngrihet mbi shtyllat e së vërtetës." U shpreh dr. Gentiana Sula.



Vizitë e ish-ambasadorit të Prezencës së OSBE-së në Autoritet

Më 16 maj, ish-ambasadori i OSBE-së në Shqipëri z. Bernd Brochardt i shoqëruar nga bashkëshortja Barbara dhe Michael Strauven zhvilloi një vizitë private në Autoritetin për Informim mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit.

👉 Kryetarja e Autoritetit znj. Gentiana Sula i njohu me mjediset e reja të arkivit, me fond të organizuar dhe sistemuar tashmë si dhe me zyrat e stafit.

Po ashtu u diskutua për rolin e rëndësishëm që këto institucione kanë në krijimin e narrativës



të së shkuarës dhe kujtesës. ✅

Sipas Brochardt:

"Kultura e kujtesës e lidhur me viktimat dhe me vuajtjet përforcon

ndryshimin e rrëfimit që është i nevojshëm për të

ndërtuar një shoqëri liberale pas shpërbërjes së një diktature."



Autoriteti përfaqësohet me punime në Konferencën “Dritëhije”



Autoriteti u përfaqësua me disa punime në konferencën "Dritëhije", të zhvilluar më 23 maj, në Muzeun Kombëtar "Shtëpia me Gjethe". Përmes punimeve të prezantuara nga znj. Marte Pllumi, znj. Enxhi Beka dhe znj. Ajkana Toni, të fokusuar në trajtimin e historisë, ngjarjeve dhe njerëzve, u hodh dritë mbi dokumente të shqyrtuara dhe analizura, të krijuara nga regjimi komunist.

Ceremonia përkujtimore në nderim të viktimave dhe të dënuarve politikë të revoltës së 22 majit të vitit 1984, e njohur si revolta e Qafë-Barit



Më 23 maj 2022, u organizua ceremonia përkujtimore në nderim të viktimave dhe të dënuarve politikë të revoltës së 22 majit të vitit 1984, e njohur si revolta e Qafë-Barit. *E nxitur nga kushtet e këqija dhe dhunës së ushtruar në burgun e Qafë-Barit, ajo nuk ishte vetëm revoltë politike kundër sistemit, por edhe thirrje për liri, si shprehja më e lartë e dinjitetit njerëzor.*

Në aktivitetin e organizuar nga Instituti i të Përndjekurve Politikë, në bashkëpunim me AIDSSH, morën pjesë ish të burgosur politikë, familjarë të viktimave, përfaqësues të shoqatave dhe institucioneve të ndryshme. Z. Eris Agolli, specialist pranë IPP-së theksoi se e kemi detyrim të kujtojmë jo vetëm ngjarjet por edhe personazhet e rezistencës. Në fjalën e tij Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit z. Skënder Vrioni shprehu rëndësinë e njohjes së të vërtetës edhe përmes dokumenteve të ish Sigurimit të Shtetit dhe ndërtimin e narrativës së të shkuarës mbi fakte historike. Në fund të fjalës z. Vrioni lexoi për të pranishmit “Masakrën e syve” shkruar nga



Visar Zhiti ish i dënuar politik në Qafë-Bari. Drejtor i Informacionit z. Selami Zalli, solli në vëmendje disa nga figurat e kësaj revolte bazuar në materialet që Sigurimi i Shtetit ka dokumentuar, si dhe ftoi të pranishmit të aplikonin pranë AIDSSH, për të tërhequr dosjet e tyre apo të familjarëve dhe për t'u njohur me fatin e tyre. Po ashtu z. Zalli prezantoi botimet e Autoritetit si produkte të përfituara nga njohja e dosjeve trajtuar nga studiues dhe historianë të ndryshëm.

Ish i burgosur në Qafë-Bari z. Dush Martini, tregoi për të pranishmit sesi bashkë me shokët rikujtuan vuajtjet e asaj kohe duke fjetur në gërmadhat e ish kapanonit të fjetjes në kushte të vështira për dy netë duke mbajtur edhe një zjarr ndezur në kujtim të shpirtrave të shokëve të vrarë dhe të pagjetur për të cilët nuk do të rreshtin kurrë së kujtuari e kërkuari.

Z. Luigj Mila foli për bashkimin e të përndjekurve politikë, mirëmbajtjen e institucioneve të kujtesës dhe përfshirjen e ngjarjeve historike lidhur me përndjekejn në kurrikulat shkollore. Po ashtu edhe z. Leonard Lame u kërkoi shoqatave të të përndjekurve të bashkohen dhe për të përmbushur qëllimet e tyre.

Z. Nikollaq Kristo ish i dënuar në Qafë-Bari, njëkohësisht i angazhuar edhe me çështjen e të zhdukurve në AIDSSH solli përvojën e vetë të dhimbshme duke kujtuar vuajtjet e asaj periudhe.

Ekspozita “Udha e kujtesës / Remembrance path”, në Lushnjë



Më 26 maj, në kuadër të projektit “*Profilet e së shkuarës: Lufta për liri dhe demokraci gjatë regjimit të Hoxhës*”, i Universitetit të Tiranës, Universiteti Sapienza i Romës, Fondazione di Storia Onlus, Shoqata Zëri Qytetar dhe ISEM, mbi dokumente të vëna në dispozicion nga Autoriteti, u zhvillua në Lushnjë ekspozita: “**Udha e kujtesës / Remembrance path**”, me praninë e kryetares së bashkisë, znj. Eriselda Cefa.

Ekspozita me portrete të të dënuarve politikë me internim në ish-ndërmarrjen “28 Nëntori” prezantoi për të pranishmit dhe të rinjtë historinë e disa dekadave më parë në vend, duke zbuluar problemet e shoqërive diktatoriale, mohimin e të drejtave dhe lirisë për breza me radhë. Autoriteti ka bashkëpunuar me vënien në dispozicion të dokumenteve mbi dëbim internimet në zonë, të trajtuara në kuadër të hulumtimeve. Po ashtu, me kontakte të të ndëshkuarve me

internim, të cilët u bënë pjesë e dokumentarit dhe dëshmime gojore të mbledhura për këtë qëllim. Një projekt mbi historitë e patreguara të Lushnjës është iniciuar e synon të zhvillohet në dimension të gjerë.

Në aktivitet, në ekspozitë dhe dokumentar, morën pjesë përfaqësues të institucioneve publike dhe organizatave joqeveritare, ish-të dënuar politikë, familjarë të tyre dhe të rinj. Nga Autoriteti, kryetarja Gentiana Sula, Simon Mirakaj, i mbijetuar i dekadave internim në zonë, Anton Dukagjini e Roland Çausaj, dhe Reald Keta, drejtor i të zhdukurve.

Studentët e Fakultetit të Drejtësisë, vizitë në Autoritet

Më 30 maj, studentët e Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, të shoqëruar nga znj Klesta Hysi, lektore pranë Departamentit të së Drejtës Publike dhe përgjegjëse për mbulimin e lëndës “Mbrojtja e të Dhënave Personale” dhe znj. Iris Pekmezi, pedagoge e jashtme e lëndës, zhvilluan një vizitë në mjediset e Autoritetit në kuadër të zhvillimit të orëve praktike.



Njohja mbi veprimtarinë e institucionit, organizimi i punës si dhe raporti që mbahet mes informimit/transparencës dhe mbrojtjes së të dhënave personale ishin disa nga çështjet që u trajtuan gjatë këtij takimi.

Kryetarja e Autoritetit znj. Gentiana Sula i njohu studentët me ligjin Nr. 45/2015 i cili ka për qëllim të përcaktojë rregullat dhe procedurat për të bërë të mundur ushtrimin e së drejtës nga çdo i interesuar për informimin mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, nëpërmjet një procesi demokratik dhe transparent, mbrojtjes së personalitetit të individit, si dhe unitetit e pajtimit kombëtar.

Po ashtu ata patën mundësi të shihnin nga afër edhe dosje të ish Sigurimit të Shtetit për të cilat studentët mund të aplikojnë për t'i studiuar nga afër dhe për t'u njohur me tipologjitë e ndryshme dhe përmbajtjen e tyre.

Z. Zalli, Drejtor i Informacionit tregoi rëndësinë e informimit, njëkohësisht i njohu edhe me rastet kur ndalohet përdorimi i të dhënave personale në dëm të personave të prekur apo palëve të treta, kur këto të dhëna janë përfutur në mënyrë të fshehtë apo të paligjshme, me përjashtim të rasteve si më poshtë:

a) të përdorimit për qëllime rehabilitimi të personave të vdekur apo të zhdukur;


b) kur këto të dhëna rezultojnë tërësisht apo pjesërisht të gabuara, për shkak të informacioneve të mbledhura.



2. Autoriteti merr masa për ndalimin e përkohshëm të përdorimit të dokumenteve të ish Sigurimit të Shtetit, kur prokuroria ose gjykata përcakton se nga përdorimi i tyre mund të dëmtohet veprimtaria hetimore, ndjekja penale, ecuria ose përfundimi i një procedimi penal të regjistruar. Ky ndalim përfundon kur përdorimi i dokumenteve nuk përbën më rrezik për procedimin penal.

3. Autoriteti merr masa për ndalimin e përkohshëm ose të përhershëm të të dhënave të ish-Sigurimit të Shtetit, kur gjykon se përdorimi i tyre mund të përbëjë rrezik real për sigurinë kombëtare.

Kujtesa Evropiane 2022


Simpoziumi i 10-të i Kujtesës Evropiane u zhvillua më 1-3 qershor 2022, në Dublin.  Qëllimi i organizimit ishte shkëmbimi i përvojave dhe bashkëpunimi mes institucioneve të vendeve të ndryshme të cilat prezantojnë modelet më të mira në shërbim të pajtimit, paqes dhe ndërtimit të Kujtesës Evropiane.

Fokusi kryesor i simpoziumit ishte roli i pajtimit në kontekstin e konflikteve historike dhe bashkëkohore evropiane, të brendshme dhe ndërkombëtare, si dhe krijimi i një atmosfere bashkëpunimi dhe mirëkuptimi.



Institucione të ndryshme, me larmi aktivitete, përpiqen të marrin pjesë në formësimin e perceptimit publik të historisë në nivel lokal, rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Çështjet e lidhura me historinë dhe përkujtimi i ngjarjeve dhe figurave të caktuara historike janë gjithnjë e më të spikatura në diskursin akademik, politik dhe publik.



 Shqipëria u përfaqësua nga ekipi i AIDSSH i kryesuar nga Kryetarja e AIDSSH, Dr. Gentiana Sula, anëtare vëzhguese e Bordit Këshillues në ENRS.

Studiues në Autoritet

Studiuesja Lea Ypi, autore dhe akademike shqiptare, profesoreshe e Teorisë Politike në London School of Economics, u njoh me materiale të ish-Sigurimit të Shtetit, në interes të saj, pranë zyrave të Autoritetit.

Autoriteti fton studiuesit dhe mediat të aplikojnë për t'u njohur me tipologjinë e dokumenteve të Sigurimit mbi ngjarjet, përndjekjen, dënimet, survejimet, arratisjet e raportimet, në linkun:



Zgjedhja e anëtarëve të Autoritetit

Kuvendi i Shqipërisë, mori në shqyrtim në seancën plenare të 9 qershorit, 5 projektvendime për zgjedhjen e anëtarëve të rinj të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.



Pas votimit, u konfirmuan si trupë drejtuese e Autoritetit, të zgjedhurit nga Kuvendi:

- ✔ Z. Albert Nikolla, anëtar, me 86 vota pro, 29 kundër dhe 4 abstenim.
- ✔ Znj. Gentiana Sula, anëtare, me 105 vota pro, 1 kundër, 1 abstenim.
- ✔ Z. Altin Hoxha, anëtar, me 80 vota pro, 2 kundër, 1 abstenim.
- ✔ Z. Gjergj Marku, anëtar, me 83 vota pro, 2 kundër, 0 abstenim.
- ✔ Z. Skënder Vrioni, anëtar, me 85 vota pro, 7 kundër, 5 abstenim.

Diskutime për të nxitur përpjekjet për identifikimin dhe gjetjen e trupave të personave të zhdukur gjatë regjimit komunist në Shqipëri.

Me mbështetjen financiare të Fondacionit Konrad Adenauer, Prezenca e OSBE-së, më 13 qershor, u organizua tryeza teknike e radhës e Grupit të Punës për të nxitur përpjekjet për identifikimin dhe gjetjen e trupave të personave të zhdukur gjatë regjimit komunist në Shqipëri.



Tryeza mblodhi përfaqësues nga institucione shqiptare dhe ndërkombëtare të përfshira në këtë proces, si Ministria e Brendshme, Prokuroria e Përgjithshme, Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit 1944-1991, Policia e Shtetit, Instituti i Mjekësisë Ligjore, dhe Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur.

Tryezat janë platformë diskutimesh mes institucioneve mbi rolin dhe kapacitetet e tyre në çështjen e përbashkët të identifikimit dhe rikuperimit të trupave, bashkërendimin e punës dhe bashkëveprimin me njëri-tjetrin, si dhe hartimin e akteve nënligjore dhe protokolleve të punës që nevojiten për të përparuar me këtë çështje.

Mbështetje për veprimtarinë e Autoritetit në zbardhjen e së shkuarës komuniste

Më 16 qershor, Ambasadori i Gjermanisë, z. Peter Zingraf, ambasadorja e Francës në Shqipëri, znj. Elisabeth Barsacq dhe kryetarja e Komisionit të ligjeve në Kuvendin e Shqipërisë, znj. Klotilda Bushka, vizituan Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, pak ditë para ceremonisë zyrtare të përrurimit të mjediseve të reja të institucionit.

Ambasadorët u pritën nga anëtarët e Autoritetit, të cilët i njohën me punën e institucionit, sfidat e tashme e të ardhme, dhe me hapësirat e reja ku zhvillon veprimtarinë Autoriteti.

Gjatë vizitës, znj. Gentiana Sula i njohu përfaqësuesit diplomatikë me punën e bërë që në themelimin e institucionit, vendimi i parë për të cilin ishte caktimi i ndërtesës së Autoritetit. Për vite me radhë u punua për rikonstrukcionin sipas standardeve bashkëkohore të ruajtjes dhe sigurisë, me mbështetjen e ambasadës suedeze në Shqipëri.

Ambasadorët vizituan arkivin e dokumenteve të Sigurimit dhe u informuan për proceset e punës, mënyrën e ruajtjes, tipologjinë e dosjeve, etj.

Diskutimet mbi synimet e Autoritetit dhe punën në të ardhmen vijuan në sallën e mbledhjeve.

▪ **Znj. Gentiana Sula** bëri një paraqitje të punës së institucionit gjatë mandatit të parë, sa i takon informimit të qytetarëve, studiuesve dhe mediave mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, si dhe strukturës së posaçme për të zhdukurit në komunizëm, të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë.

▪ **Z. Gjergj Marku** falënderoi ambasadorët për mbështetjen ndaj Autoritetit dhe renditi problematika në trajtimin e së shkuarës, sa i takon përdorimit të burimeve në kurrikulat shkollore, ruajtjes së vendeve të dënimit e ndëshkimit në mbarë vendin nga institucionet vendore e qendrore, rolit të mediave, që e shkuara të mos përsëritet.

▪ **Z. Skënder Vroni** solli në vëmendje punën e bërë nga institucioni në bashkëpunim me partnerë, organizata dhe shoqata, mbi kampin e Tepelenës, atë të Maliqit, si dhe të zhdukurit. Ai e vuri theksin te vijimësia e projekteve të nisura, sa i takon vendeve të kujtesës, kërkimit shkencor dhe të zhdukurve në komunizëm.

▪ **Ambasadorja Barsacq** nënvizoi rëndësinë e institucioneve të tilla, dhe mundësinë që duhet t'i jepet çdo familjeje e çdo individi që të përballet me të shkuarën. Kujdesi për të gjitha rastet, të



trajtuara sipas standardeve, është i rëndësishëm për shoqërinë e sotme shqiptare dhe atë të së nesërme.

■ **Ambasadori Zingraf**, nga ana e vet përsëriti mbështetjen për Autoritetin, duke marrë shembull rastin e Gjermanisë, sa i takon politikave për ballafaqimin me të shkuarën. Për këtë është e nevojshme që të gjitha institucionet e përfshira të koordinohen dhe bashkëveprojnë.

Vullneti politik, qasja e institucioneve, organizatave dhe shoqërisë, ndërveprimi mes tyre, po ashtu aksesimi i qytetarëve, studiuesve dhe mediave në informim, është e rëndësishme të reflektohet edhe në synimet e trupës së drejtuese, e cila ka përgjegjësinë e trajtimit të së shkuarës me profesionalizëm, integritet dhe duke vënë qytetarin në qendër.

Për Autoritetin, sfidat e mandatit të dytë kanë të bëjnë me kthimin e tij në institucion kujtuese, që përveçse zbërthen makinerinë e shtypjes, sjell edhe zërin e qëndrimin e viktimës, duke krijuar kuadrin e plotë historik të diktaturës.

Njëherësh, një qendër e vizitueshme, me mundësi leximi e njohjeje me dokumentacionin, po ashtu, një instrument që ndihmon për zberthimin e së shkuarës dhe hetimin e fatit të viktimave të pagjetura.



Përurohet ndërtesa e rikonstruktuar e Autoritetit, dokumentet e Sigurimit të Shtetit në një arkiv të integruar

Më 27 qershor, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar në Tiranë (SIDA) zhvilluan ceremoninë e përuimit të ndërtesës së rikonstruktuar të AIDSSH-së dhe shërbimeve TIK për krijimin e një arkivi modern, në mjediset aktuale të Autoritetit, pranë Ministrisë së Mbrojtjes.



Projekti i mbështetur nga Qeveria Suedeze, - sipas marrëveshjes së grantit me Autoritetin, për infrastrukturë bashkëkohore e kushte moderne për ofrimin e shërbimeve qytetarëve dhe studiuesve - u prezantua për përfaqësues të Kuvendit të Shqipërisë, të institucioneve publike, qendrore e lokale, shoqatave të drejtave të njeriut dhe të përndjekurve politikë, trupit diplomatik, organizatave ndërkombëtare në kryeqytet, përfaqësues të universiteteve dhe institucioneve kërkimore në vend, përfaqësues të institucioneve homologe me të cilat AIDSSH



bashkëpunon që prej krijimit.

Në fjalën e saj, znj. Gentiana Sula u shpreh se: “Dy arritje të mëdha i atribuohen projektit bujar të Qeverisë Suedeze: nga njëra anë, sot arkivi i Sigurimit është vendosur në mjediset e institucionit; ruhet në kushtet më të mira të sigurisë, dhe pritet të pasurohet ende, në vijim të marrëveshjeve që Autoriteti zbaton me partnerët, për grumbullimin në një vend të vetëm të të gjitha dokumenteve të Sigurimit.



Nga ana tjetër, është krijimi i shërbimeve TIK për një arkiv modern. Hapa të rëndësishëm janë bërë në këtë drejtim, sa i takon infrastrukturës digjitale, me serverë, kompjuterë të tempestuar dhe krijimin e një softëare të posaçëm, që koordinon punën me dokumentet e Sigurimit si dhe punën e të gjitha drejtorive, duke rritur eficiencën dhe efikasitetin”.

Znj. Elsa Håstad, Ambasadore e Suedisë në Shqipëri nënvizoi faktin se: “Arkivi i dokumenteve të veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit është zanafilla e punës së Autoritetit, është tërësia e dokumentacionit që mundëson informacion, njohuri dhe prova për secilën çështje.

Kërkimi i së vërtetës, veçanërisht kur është e hidhur dhe e dhimbshme, është gjithmonë detyrë e vështirë. Kjo bëhet edhe më sfiduese, nëse kryerja e detyrës nënkupton “shkeljen në kallo të disave”, por nuk ka asnjë formë tjetër nëpërmjet së cilës drejtësia të vihet në vend, përveç përballjes me të vërtetën, e kjo mund të realizohet vetëm duke u bazuar në prova konkrete, hulumtim serioz dhe transparencë”.



Znj. Ermonela Felaj (Valikaj), nënkryetare e Kuvendit të Shqipërisë theksoi rëndësinë e institucioneve të informimit dhe kujtesës për vendin, për përballjen me të shkuarën dhe hedhjen e bazave për një të ardhme të pajtimit dhe unitetit kombëtar.



Znj. Orjola Pampuri, deputete në Kuvend, përsëriti mbështetjen për Autoritetin dhe nismat e ndërmarra prej tij në vite, duke nënvizuar vlerën e hulumtimit mbi baza shkencore në dokumentet historike dhe duke i lidhur ato me njerëzit, të mbijetuarit, viktimat, për ta bërë edhe zërin e tyre të dëgjohet.



Znj. Ardiana Topi, drejtoreshë e arkivit të Autoritetit, bëri një paraqitje të detajuar të sistemit digjital me të cilin do të punohet me dokumentet arkivore, duke prezantuar një ndër hapat e rëndësishëm të projektit me Qeverinë Suedeze. Aktiviteti vijoi me vizitën e të pranishmëve në arkivin e Autoritetit, ku për herë të parë janë grumbulluar në një vend të vetëm, në kushtet më të mira të ruajtjes dhe sigurisë, dokumentet e

Sigurimit, pas tërheqjes nga dy vendruajtjet arkivore pranë SHISH e IPQP, në kushte të papërshtatshme, sidomos pas tërmetit.

Bashkëpunimi me SIDA-n në Tiranë u zyrtarizua në vitin 2019, pas vizitës në arkivat e institucionit, të partnerëve dhe përfaqësuesve diplomatikë të interesuar të mbështesin drejtësinë tranzicionale në vend dhe shoqatat e të drejtave të njeriut.

Përgjatë kësaj kohe u punua për krijimin e kushteve bashkëkohore të punës, me arkiv të standardeve moderne, zyra pune dhe mjedise për hulumtim shkencor, bibliotekë e sallë ekspozimi.

Ndërtesa ku Autoriteti zhvillon veprimtaritë e tij iu dha institucionit nga Qeveria shqiptare, në vitin 2017. Projekti u realizua nga Instituti i Ndërtimit. PNUD në Shqipëri kontribuoi për infrastrukturën fizike ku mbështeten veprimtaritë e tij, numeralizimi i arkivit dhe çështjet TIK.



NJOHJA NXIT STUDIMIN

NJOHJA NXIT STUDIMIN

Imazhe, armiq dhe vese në shoqërinë komuniste

👉 *Studimi u përgatit nga PhD. Julian Bejko, në kuadër të konferencës ndërkombëtare shkencore “Fytyra e “Armikut” të popullit” të AIDSSH, në bashkëpunim me ASA, ISKPK, IIPP dhe Muzeun Historik Kombëtar*

PROFILE TË
“ARMIKUT TË POPULLIT”
NË DIKTATURË



KONFERENCË NDËRKOMBËTARE SHKENCORE

1. Populli si vetëimazh – Mes gjurmëve të kalvarit komunist kinemaja shqiptare është korja fertile e një toke të keqkuptuar, në trupin e saj është qepur fjala, zakoni dhe bestynia dhe me ngut ushqehemi prej tyre. Nëpër lumenjtë e imazheve shihemi herë me bezdi dhe herë me pasionin e trishtë të nostalgjisë, imazhe që rrëfejnë përvojën rrugëtimit tonë. Aty flitet për një Si dhe Çfarë ka mbetur gjatë procesit të ndryshimit. Herakliti i nënqeshur do thosh se shqiptarët janë ende anës lumenjve dhe ngurojnë të lahen.

2. Veshë të vërtetë – Për të dëgjuar zërin e shoqërisë duhen veshë të hapur ndaj çdo tingulli që vjen prej shtresave të imazheve me qëllim që të kuptohet diçka. Në shkallë të ndryshme njerëzit mësojnë sipas asaj që janë, sipas asaj që grumbullojnë vetë dhe së treti, sipas asaj që i kanë mësuar të

tjerët, kryesisht opinione dhe gjykime. Por kush kërkon të kuptojë ndonjë gjë në fushëbetëjen e jetës duhet të shkundet nga opinionet, gjuha dhe zakonet që nuk i shërbejnë më të ardhmes.


3. Para zhytjes – Ashtu siç njerëzit i bien shkurt për të arritur me një frymë në përfundime të papjekura, shpesh edhe kërkuesit vuajnë nga të njëjtat paragjykime dhe klaustrofobi kronike. Dhe në përfundim të veprës ka mbijetuar vetëm era mbytëse e objektivitetit ndërsa rreth kërkuesit s’ka gjurmë. Në të gjitha udhëtimet e panjohura, lipset frymëmarrje e fortë dhe e thellë për t’u zhytur shtresat e kohës.

4. Nëntokë – Njeriut i janë dashur mijëvjeçarë për të nxjerrë majën e këmbës nga çorba e fjalëve dhe gjërave, përgje në të cilat pengohemi e rrëzohemi qysh herët. Por me të hyrë në shpellën e mitit kërkuesi takon të shkuarën plot frikë dhe pasiguri. Do të jenë shoqëruarit e tij ndaj duhet të kuptojë tokën në të cilën kanë jetuar të mbijetuarit.

5. Shkallë dhe shndërrime – Në kontaktin me të shkuarën – e cila mund të jetë fosilizuar në trajtën e dokumentave, letërsisë, muzikës, filmit etj., – në këtë mozaik pikasen mjekime të shpirtit dhe veshje për trupin e ftohur. Ato imazhe janë endur e gdhendur nga shumë duar anonime dhe duhen konsideruar faktet e vetme për t’u prekur me dorezat e etikës. Përfaqësuesit e opinionit dhe zbatuesit e moralit do të kërkojnë përherë përgjegjës dhe fajë sipas perspektivës së viktimës. Gjuha bëhet dramatike se kështu kërkon të rifitojë autoritetin e cinguar, pa kuptuar që s’është veç një zë në pentagramin e pafundëm të jetës.

“Kleri katolik shqiptar si imazhi simbol i perceptimit të armikut të popullit nga diktatura komuniste në Shqipëri”

👉 Në nderim të Dod Dedë Malaj dhe dhe gjithë personaliteteve të përndjekur dhe dënuar nga regjimi komunist sjellim në vëmendje studimin e Gjon Boriçit pjesë e botimit "Profilet e Armikut të Popullit":



➡ **Dom Dedë Malaj** u dënuar me vdekje më 27.04.1959 dhe u pushkatua në Breg të Liqenit më 12.05.1959.

Lindi në Malkolaj të Velipojës më 16.11.1917. Shkollën fillore e bëri në vendlindje. Ndoqi Seminarin Papnor Shqiptar të Shkodrës. Studioi Filozofi e Teologji në Kolegjin Urban të Kongregatës Propaganda Fide të Romës dhe në Kastel Gandolfo të Romës. U shugurua meshtar në Kastel Gandolfo më 20.12.1942. U emërua Famullitar i Pulajve të Velipojës, i Dajçit të Bregut të Bunës dhe i Malkolajve. U arrestua dy herë, në Pulaj të Velipojës më 1948 dhe në Dajç më 07.11.1958 dhe u burgos në Shkodër.

Trupi i tij u zhvarrosur prej varrezave të Dajçit të Bregut të Bunës me rastin e Lumnimit.

Gjatë 45 viteve dikturë komuniste në Shqipëri, krijimi i imazhit të “armikut të popullit” nga klasa politike në pushtet ndikoi jo pak në perceptimin dhe konsolidimin e diktaturës. “Armiq të popullit” u shpallën të gjithë kundërshtarët e regjimit komunist në Shqipëri, ku theks të veçantë mori lufta e ashpër ndaj fesë dhe mbi të gjitha kundër klerit katolik. Në këtë kumtesë do të përpiqemi të japim një tablo sa më koncize sesi kleri katolik nëpërmjet rolit të tij aktiv në kulturën dhe jetën shqiptare u etiketua në rrethanat e dikturës komuniste si reaksionar dhe figura simbol e armikut të popullit. Papajtueshmëria e doktrinës fetare katolike me doktrinën marksiste/komuniste është një tjetër element që ndihmoi diktaturën komuniste shqiptare që të etiketonte si “armik të popullit” klerin katolik shqiptar. Me po të njëjtin sy u panë si kundërshtarë dhe armiq të popullit edhe katolikët laikë sepse numri shumë i paktë i intelektualëve që ekzistonin asokohe në Shqipëri përbëhej në masë të konsiderueshme nga katolikë të cilët ishin të arsimuar në perëndim. Kundër klerit katolik u përdor një makineri e tërë propagande për ta bërë sa më të besueshëm në popull imazhin e tij si “armik”. Kisha Katolike e Shqipërisë dhe kleri katolik ndër më të vjetrit në botë, ka përjetuar një persekutim të pashembullt nën regjimin komunist shqiptar. Pjesëmarrja e dukshme e Kishës dhe klerit katolik shqiptar në jetën kulturore e sistemin arsimor të Shqipërisë padyshim që do të gjente kundërshtimin dhe armiqësinë e hapur të diktaturës komuniste shqiptare. Kjo kumtesë sjell një risi në shkencën historike shqiptare pasi bazohet në hulumtimin e studimin e dosjeve origjinale arkivore që kanë qenë për shumë kohë të mbyllura dhe të paaksesueshme për studiuesit dhe publikun shqiptar. Studimi që do të paraqesim është historiko-analitik lidhur me një nga periudhat më të vështira që kaloi Shqipëria dhe populli shqiptar nën diktaturën komuniste.



AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT

Adresa
Njësia Administrative nr. 4, Rruga e Dibrës,
garnizoni “Skënderbej”, Tiranë